



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Komuna e Drenasit
Drejtoria për Administratë të Përgjithshme
Zyra e Prokurimit



KONTRATË KORNIZË - SHËRBIMI

KUSHITET E PËRGJITHSHME, TË VEÇANTA DHE ANEKSET E NDËRLIDHURA

TITULI: KYQJA E INETRNETIT NE 26 SHKOLLA

numri identifikues: 611-19-016-221, nr. i arkivit : 02-400- 31662 përgaditur ne Drenas: 10.06.2019

palët në marrëveshje

1. Komuna e Drenas-it - Drenas, përfaqësuar nga Mensur Gllareva, zyrtar i prokurimit (më tutje "punëdhënës")
2. NNP "BUSHI TELEKOM" – DRENAS , perfaqsuar nga: SHERIF ISTAOGLU , drejtor (me tutje "kontraktues")

Neni 1: Lënda

1.1 Lënda e kontratës duhet të jetë kryerja e shërbimeve nga kontraktuesi në vijim **KYQJA E INETRNETIT NE 26 SHKOLLA**

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. P.sh. Kurdo që Autoriteti Kontraktues apo ndonjë Autoritet tjetër Kontraktues i përfshirë në këtë kontratë, tenton të blejë artikuj në bazë të kësaj kontrate publike kornizë, duhet që të dërgojë "porosinë" tek Ofruesi i sherbimeve, duke specifikuar listën e sherbimeve qe duhet te performohen me sasitë e tyre përkatëse.

1.3 Sasitë e vlerësuara, të përcaktuara në Pjesën C, Lista e Çmimit, janë vetëm sasi indikative dhe NUK detyrojnë Autoritetin Kontraktues të blejë ndonjën prej tyre. Autoriteti Kontraktues me të drejtë të tij mund të blejë më pak ose më shumë sasi se sa ato sasi të vlerësuara për artikull p.sh brenda një pjese (loti) të njëjtë. Megjithatë, Autoriteti(ët) Kontraktues i përmendur në Nenin 1.1 është (janë) të detyruar të përdorin këtë marrëveshje kornizë sa herë që të prokuojnë shërbimet e përmendura në 1.1.

1.4 Ofertuesi i Shërbimeve NUK do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do ti lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë, për shembull në rast se autoriteti kontraktues vendosë të blejë më pak apo më shumë sasi se sa ato të parapara të specifikuara dhe/ose në rast se autoriteti kontraktues vendos të MOS blejë ASNJË nga këto sasira për disa artikuj.

1.5 Kontrata hynë në fuqi me 11.06.2019 dhe perfundon me 11.06.2022 .

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 36 muaj nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i kryerjes së shërbimeve do të jetë: INSTITUCIONET SHKOLLORE TE KOMUNES SE DRENASIT.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet e shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare. **16,848.00€** (Gjashtëmbedhjetëmijë e Tetë qind e Katerëdhjet e Tetë euro).

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Ofruesit te Shërbimeve sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të janë fiksë dhe nuk do ti nënshtrohen ndryshimeve për porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesat do të bëhen në përputhje me Kushtet e Përgjithshme dhe/ose të Veqanta të Kontratës.

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Ofriuesit te Shërbimeve, duke përfshirë Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (f) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofriuesit të Shërbimeve nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përvës nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofto", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhjet Shqipe në tri origjinale, dy origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofriuesin e Shërbimeve.

PJESA II E KONTRATËS

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofriuesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofriuesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofriuesit të Shërbimeve.

1.3 "Ofriues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grapi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhe që për detyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat e angazhuar nga Ofriuesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit e tij ligjor ose transferimet e lejuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet ose ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofriuesi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkuption Autoritetin Kontraktues ose Ofriuesin i Shërbimeve, siç mund të jetë rasti, dhe "Palë" nënkuption të dy prej tyre.

1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkuption autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 "KPK" nënkuption Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.1 O "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet e shkruara ndërmjet palëve hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofroresi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofroresi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përveç në këto raste:

- a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofroresit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose
- b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofroresit të Shërbimeve siguruesve të Ofroresit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofroresit të Shërbimeve.

3.3 Për qillimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofroresin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhënien e kontratës përveç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofroresi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjesë të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Ofroresi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit kontraktues.

Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofroresin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njohimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve.

4.4 Ofroresi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofroresit të Shërbimeve, agjentëve të tij ose punëtorëve të tij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjesë të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit kontraktues nuk e liron Ofroresin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimet dhe Detyrimet

5.1 Ofroresi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha taksat dhe doganat në pajtim me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Ofroresi i Shërbimeve, Nënkontraktuesit, dhe Personeli i tyre do t'i paguaj ato taksa, dogana, tarifa dhe detyrime të tjera që mund të vendosen sipas ligjit në fuqi, shuma e të cilave mendohet të ketë qenë e përfshirë në çmimin e kontratës.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofroresi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofroresi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtari brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofroresi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofruesi i snervimit mund te kerkoje zgjatje te periuanes se ekzekutimit nese reanizimi i kontrates se tij vonohet, ose pritet se do te vonohet, per ndonjeren nga keto arsyet:

- a) deshthimi i Autoritetit Kontraktues per te permbushur detyrimet e tij sipas kontrates;
- b) forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me te kuptuar se një vonesë mund te ndodhë, Ofruesi i Shërbimeve do te njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin e tij që te bëj një kërkesë per zgjatjen e periudhës se realizimit per te cilën ai konsideron se ka te drejtë dhe, përveçse kur eshtë rënë dakord ndryshe ndërmjet ofruesit te shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjtë pikë në kohë te sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi te plotë në mënyrë që te mund te shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive te përmendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë te njoftimit me shkrim do t'i lejoj Ofruesit te Shërbimeve zgjatjen e periudhës se ekzekutimit siç mund te arsyetohet, ose në mënyrë prospektive dhe retrospektive, ose te informoj Ofruesin e Shërbimeve që ai nuk ka te drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje te obligimeve te saj sipas kontrates nese realizimi i obligimeve te tilla parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës se njoftimit mbi dhënie te kontrates ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do te thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin te deklaruara ose jo, blokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtima, vërshimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje tjetër e ngjashme e paparashikuar që eshtë përtëj kontrollit te palëve dhe nuk mund te përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do te marr te gjitha masat e arsyeshme per te mënjanuar paaftësinë e një pale te tillë që te përbush detyrimet e saj tanë e tuje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do te jetë përgjegjës per dëmet e likuiduara ose ndërpërje nese vonesa e tij nese realizimin ose dështhimi per te realizuar obligimet e tij me kontratë eshtë rezultat i një ngjarjeje te forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do te jetë i detyruar te paguajë interes per pagesat e vonuara, per mosrealizim ose per ndërpërje nese vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dëshimit per te kryer obligimet e tij eshtë rezultat i forcës madhore.

8.5. Nese ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund te ndikoje nese realizimin e obligimeve te saj, menjëherë do ta lajmërojë palen tjetër, duke dhënë te dhëna detaje mbi natyrën, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nese udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do te vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontrates përderisa eshtë mjaft praktike, dhe te angazhojë te gjitha mjetet e arsyeshme alternative per te plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore te mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do te zbatojë mjetet te tilla alternative përvëç nese udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërpërja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit te Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati te arsyeshëm te paralajmërimi te dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai te evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim per te realizuar obligimet e veta sipas kontrates, dhe te cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe me kohë te shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose eshtë neglizhent në realizimin e urdhreve administrative te dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose eshtë duke u mbyllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtrohet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose eshtë në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në irregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve eshtë dënuar per një shkelje që ka te bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve eshtë shpallur fajtor per sjellje te rendë te keqe jo profesionale te dëshmuar me çfarëdo mjeti te cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;

(g) Ofruesi i Shërbimeve i esnte nensntruar një gjykimi që ka rorcen e *res judicata* per masntrum, korrupcion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;

(h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përvèç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;

(i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;

(j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të jep garancinë apo sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershëm të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruajë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëhershëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zgogluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpërt kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet t'i paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose

c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një periudhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontratës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrues i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përqyeshimtë të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmët e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë të dhënë të kontratës, pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tillë do të janë së bashku dhe veçmës të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrimtë Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identifikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkese me shkrim dhe të arsyetuar, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatajë dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neri 12 Obigimet e Autoritetit Kontraktues

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tillë duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neri 13 Dëmet e Likuiduara

13.1 Nëse Ofruesi i shërbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha shërbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së shërbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zgresë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Shërbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin detyrimet e Ofruesit te Shërbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit shërbime parandalon përdorimin e zakonshëm të shërbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta njoftojë me shkrim Ofruesin e Shërbimeve të:

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të shërbimeve. Ofruesi i shërbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

b. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i Shërbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Shërbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoriteteve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:

- Autoriteti Kontraktues i cili ka vere porosine anuion porosine ane ritenderon, ane ne kete rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do tē ketē tē drejtē pēr kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do tē jetē i detyruar tē paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe

- te rjoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin pēr sjellje tē keqe tē Operatorit Ekonomik dha kérkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe tē konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, tē garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetet e tjerë Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:

- te rjoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin pēr sjellje tē keqe tē Operatorit Ekonomik dha kérkon nga nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe tē konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, tē garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe nē kétë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do tē ketē tē drejtē pēr kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do tē jetē i detyruar tē paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur tē Operatorëve Ekonomik tē kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i sherbimeve do tē, jo më vonë se dita e nënshkrimit tē kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri pēr ekzekutim tē plotë dhe tē mire tē kontratës. Shuma e sigurisë do tē saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do tē ndalet nga pagesa e Autoritetit kontraktues pēr çfarëdo humbeje që është pasojë e mosekzekutimit tē plotë dhe tē duhur tē obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Sherbimeve.

14.2 Garancioni do tē vazhdojë tē mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit tē Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garancioni i ekzekutimit tē kontratës do tē jetë nē formatin e dhënë në Pjesën IV tē kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do tē merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Sherbimeve do tē marr dhe do tē ruaj, dhe do tē shkaktoj Nënkontraktorët tē marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por nē bazë tē kushteve tē miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe pér mbulim, siç do tē specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Sherbimeve, me kërkesë tē Autoritetit Kontraktues, do tē ofroj dëshmi pēr Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet tē përgjithshme tē pagesave

16.1 Pagesat do tē bëhen nē Euro. Pagesat qe duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Sherbimeve do tē bëhen nē llogarinë bankare tē dhënë nē Pjesën V, Identifikimi Financiar, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Sherbimeve. I njëjti formular, që i bashkëngjitet kërkesës pēr pagesë, duhet tē përdoret pēr t'i raportuar ndryshimet nē llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet tē paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data nē tē cilën kërkesa e pranueshme pēr pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do tē jetë data nē tē cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa pēr pagesë nuk do tē jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund tē pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Sherbimeve që kërkesa pēr pagesë nuk mund tē plotësohet sepse shuma nuk do tē paguhet pēr shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përbajtjesore ose sepse ka dëshmi që shpenzimi mund tē mos jetë legitim. Në rastin e fundit mund tē bëhet një inspektim i menjëhershëm pēr qëllim tē kontrollimeve tjerë. Ofruesi i Sherbimeve do tē japë sqarime, modifikime apo informata tē tjerë brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do tē llogaritet nga data nē tē cilën është regjistruar kërkesa pēr pagesë e përgatitur nē mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që tē ketë kaluar afati i fundit i dhënë nē Nenin 16.2, Ofruesi i Sherbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, tē kérkojë interesin pēr pagesë tē vonuar me normë tē re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës nē ditën e parë tē muajit nē tē cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë tē

perqinajes, interes i pageset te vonuar qo te zbatonet per konen qe kaijon nqermjet qates se aratit te runait te pageses (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jasin të drejtë Ofruësit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti kontraktues nuk i përmbrush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë APP-ja për shkelje të tilla. APP-ja mund të ndalojë autoritetin kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga APP.

Neni 17

Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli i tillë nuk do të ndikojë në përgjegjësitet e ofruesit të shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund të udhëzojë ofruesit e shërbimeve të kërkojnë një defekt dhe të zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund të ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar në KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do të njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit të kontratës. Periudha garantuese e defekteve do të zgjatet për aq kohë sa Defektit të korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet të përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korriguar defektin brenda kohës së specifikuar në njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do të vlerësoj koston e korrigimit të defektit, ofruesi i shërbimeve do të paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ezikuzitimi që llogaritet siç përshkruhet në nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin të shlyejë ndonjë nga obligimet e veta me kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do të ketë të drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërpërje të kontratës.

19.3 Përveç masave të sipërpërmendura, mund të jepen dëmshpérblime. Ato mund të jenë:

- a) dëme të përgjithshme; ose
- b) dëme të likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave të parapara në këtë nen do të zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruësit të Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë të gjitha përpjekte për të zgjidhur në mënyrë miqësore të gjitha mosmarrëveshjet që mund të ndodhin ndërmjet tyre. Sapo të shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre në mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh të dobishme, palët do të takohen dhe të mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do të i përgigjet kërkesës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do të jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për të arritur zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon të përgigjet me kohë ndaj kërkesave për zgjidhje, të dyja palët do të jenë të lira të vazhdojnë në fazën e ardhshme të procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore të mosmarrëveshjes dështon, palët mund të merren vesh të përpilen të pajtohen përmes institucionit të specifikuar në KVK. Nëse nuk mund të arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas

ministr te proceura se pajtumit, secila paie do te kete te arejte te vazndoje ne razen e aransnme te proceura së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi në pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vodosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërbëlimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërbëlej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agentet e tij dhe do te jete përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguaruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATËS KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridikioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
Gjuha	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë Gjuha shqipe
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	12.3	Autoriteti kontraktues merrë për obligim që kontraktuesit t'i siguroj kushte duke ju siguaruar zyrë të veqant për vodosjen e personelit dhe të pasijeve deri sa të zgjatë kontrata.
Programi i realizimit	12.4	Drejtoria për Shërbime Publike nëpërmes Kryetarit të komunës obligohen që të caktojnë Menaxher të projektit, të cilët duhet të hartojnë Plan të menaxhimit të kontratës konform nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për mbikqyrjen dhe raportimin për shërbimet e kryera.
Menaxhimi	12.5	Menaxheri () i caktuar ka për obligim që OE shërbyses ta përcjellë realizimin e kontratës dhe kryerjen e shërbimeve (KYQJA E INTERNETIT NE 26 SHKOLLA) ashtu si eshtë precizuar në dosjen e tenderit..
Obligimet e kontraktuesit	12.6	Kontraktuesi do t'i trajtojë të gjitha dokumentet dhe informatat e marra lidhur me kontratën si private dhe konfidenciale. Përveç në rastet kur kjo eshtë e nevojshme për qëllime të ekzekutimit të kontratës, Ai nuk do të publikojë ose shpalosë asnjë detaj të kontratës pa pajtim paraprak me shkrim nga Autoriteti kontraktues. Nëse shfaqet ndonjë mosmarrëveshje lidhur me nevojën për publikim ose shpalosje për qëllime të kontratës, vendimi i Autoritetit kontraktues do të jetë final. Shërbimet duhet të kryhen Konform standardeve të kërkua të dosje të tenderit. Nëse shërbimet janë të dobëta dhe pas tërheqjes së vërejtjes ato përserti janë të tillë, atëherë fillohet me uljen e pagesave mujore dhe nëse prapë vazhdohet

		atëherë kontrata njëanshëm ndërpritet.
Siguria e ekzekutimit	14.1	<p>Shuma e sigurise se ekzekutimit është 10 % e shumës dhe do të jetë valid 37 MUAJ. Siguria e ekzekutimit duhet të ofrohet nga OE në ditën e hyrjes në së kontratës në fuqi.</p> <p>Kontraktuesi duhet te përfundoj shërbimet sipas datës se paraparë ne nenin paraprak ne afat deri me 11.06.2022 dhe te dorëzoj raportin përfundimtar te shërbimeve të kryera në në fund të çdo muaji ku duhet përbahen te gjitha detajet për shërbimet e kryera.</p>
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	15.1	<p>Rreziqet dhe mbulesat nga sigurimi do të janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Mjetet motorike të Palës së Tretë: sipas ligjeve në fuqi b) Përgjegjësia e pales së tretë sipas ligjeve në fuqi c) Përgjegjësia e punëdhënësit dhe kompensimi i punonjësve sipas ligjeve në fuqi d) Përgjegjësia profesionale sipas ligjeve në fuqi e) Humbje ose dëmtim të pronës dhe pajisjeve sipas ligjeve në fuqi <p>Pa marrë parasysh obligimet e sigurimit qe ne baze te kontrates i takojne Kontraktuesit, Kontraktuesi do të mbajë përgjegjësi të plotë, dhe do ta sigurojë Autoritetin kontraktues dhe Drejtorinë për ARSIM nga ankesat dhe dëmet tjera të shkaktuara nënkontraktuesve dhe punëtorëve të tyre.</p>
Pagesat		<p>Për t'i marrë pagesat, Kontraktuesi duhet t'i përcjellë Autoritetit të përmendur në paragrafin 26.1 më lart:</p> <ul style="list-style-type: none"> a) Kontraktuesi obligohet që për shërbimet e kryera në muajin e kaluar, Faturën ta dorëzoj nga data 01 deri 05 e muajit në vazhdim ose në momentin e kryejrje së shërbimeve. b) Pagesa nga Komuna duhet të kryhet mundësishët menjëherë, nëse jo atëherë jo më vonë se tridhjetë ditë pas dorëzimit dhe pranimit të faturës. Ndërsa nëse pagesat vonohen nga ana e Komunës për OE shërbyes, atëherë do të veprohet konform Ligjeve në fuqi për kompensime ne vonesa në pagesa.
Kualiteti i Shërbimeve	17.1	Shërbimet duhet të kryhen Konform standardeve të kërkua të dosje të tenderit. Nëse shërbimet janë të dobëta dhe pas tërheqjes së vërejtjes ato përsëri janë të tilla, atëherë fillohet me uljen e pagesave mujore dhe nëse prapë vazhdohet atëherë kontrata njëanshëm ndërpritet.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25 % për ditë. Shuma maksimale e dëmeve të likuiduara për të gjitha Punët është 10 % e Çmimit final të Kontratës. Me propozimin e Menaxherit të Projektit dhe aprovizimin e Autorizuesit Operatori Ekonomik futet në penale nëse shërbimet janë të dobëta edhe pas tërheqjes se vërejtjes nga Menaxherit. Nëse ka sherbime të dobëta dhe Operatori Ekonomik nuk është fut në penale atëherë Menaxheri duhet të jep një arsyetim për mos futje në penale.
Monitorimi	19.1	Menaxherët e caktuar me vendim obligohen që monitorimin e kontratës në aspektin Ligjor herë pas here ta kryej konform neneve të kontratës dhe ligjeve në fuqi dhe duhet të bindet se kontrata implementohet ashtu edhe si është hartuar. Poshtu merrë përsipër së bashku me Avokatin komunal të përballet edhe me pengesat eventuale dhe mbrojtjen e kontratës dhe interesave të Komunës para institucioneve tjera.
Parapagimi	20.1	Shuma e parapagimit (avans) : 0
Mbajtja e Parasë	21.1	Shuma e parave të mbajtura është: 0 %
Pagesa pas shkëputjes së kontratës	21.2	Përqindja që do të zbatohet për vlerën e shërbimeve që nuk janë përfunduar, që përfaqëson koston shtesë të Autoritetit Kontraktuesin për kompletimin e Sherbimeve, është plus 10 % e vlerës së kontratës ose nëse dëmi është i madh deri në vlerën e përgjithshme të kontratës. Poashtu nëse kontrata ndërpritet me fajin e Autoritetit kontraktues atëherë Menaxheri jep urdhër për pagesë për të gjitha shërbimet e kryera dhe të papaguara.
Zgjidhja	21.3	Mundësishët në mes të dy palëve.

miqësore e mosmarrëve shjeve		
Zgjidhja e mosmarrëve shjeve me procedurë gjyqësore	22.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet [Gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin në Kosovë.
Mbikëqyrja	22.2	Mbikqyrës nuk mund të caktohet personi i cili ka marë pjesë në hartimin e paramasave ose specifikimeve dhe as Ai që ka marrë pjesë në vlerësimin e ofertave.
Shërbime shtesë	22.3	Shërbime shtesë mund të ketë konform kontratave kornizë + apo - 30 % të shumës së kontratës.
Pagesat	22.4	Të gjitha pagesat bëhen në euro, pasi të dorëzohen dokumentat më të domosdoshme për pagesë tek Zyrtari për pagesë dhe arkivim. Përqindja % e pagesës për shërbimet e kryera mujore.
Dorëzimi i dokumentave	22.5	Zyrtari për pagesë para se t'i kryej pagesat duhet të bindet se ju kanë ofruar të gjitha dokumentet si: Plani i menaxhimit të kontratës, aktvendimet, procesverbalet, raportet, pranimet, urdhëresat, faturat, shkresat, etj.
Arkimi i dokumentave	22.6	Zyrtari për pagesë dhe arkivim të lëndëve, obligohet që të gjitha dokumentat rrëth pagesave duke përfshirë edhe raportet e pranimit, urdhërit për pagesë dhe urdhërblerjes, t'i arkivoj dhe ruaj. Poashtu obligohet që dokumentet e kërkua nga auditorët për auditim ose nga palët shtetërore të interesuara t'ju ofroj sa herë që ata kanë nevojë.
Hyrja në fuqi	22.7	Kontrata hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit të palëve. Kontrata hartohet në 3 kopje origjinale.

Kësaj kontrate i bashkangjitet:

- a. Oferta financiare e Tenderuesit (çmimorja)

Kontrata hynë fuqi me datë: 11.06.2019 dhe perfundon 11.06.2022 .

Për Komunën e Drenas-it

MENSUR GLLAREVA

ZYRTAR PËRGJEGJËS I PROKURIMIT

Datë: 11.06.2019



Për Operatorin Ekonomik

SHERIF ISTOGU

DREJTOR

Datë:

11.06.2019



FORMULAR PËR DORËZIMIN E TENDERIT

Pjesa I. Formulari i Tenderit

Numër të Prokurimit: 611-19-2267-2-2-1

Titulli i kontratës: KYQJA ME INTERNET NE 26 SHKOLLAVE FILLORE - RITENDERIM

Si përgjigje ndaj letrës suaj të ftesës për të tenderuar për kontratën e mësipërme, ne, të poshtë nënshkruarit, deklarojmë që:

1. i kemi kontrolluar dhe pranuar plotësisht përbajtjet e dosjes së tenderit. Ne pranojmë dispozitat e saj në tërsi, pa rezervim ose kufizim.
2. Ne ofrojmë të dorëzojmë, në pajtim me kushtet e dosjes së tenderit dhe afatet kohore të paraqitura, pa rezervë apo kufizim:

1 KYQJA ME INTERNET NE 26 SHKOLLAVE FILLORE -RITENDERIM

3. Çmimi total i tenderit është:

16.848,00 EUR

Dhe në fjalë [shëno çmimin e tenderit në fjalë Euro]

4. Ky tender është valid për një periudhë prej ose muaj: ose dite: 60 nga data finale për dorëzim të tenderëve.

5. Nëse tenderi jonë pranohet, ne marrim përsipër të sigurojmë një siguri të ekzekutimit para nënshkrimit të kontratës

6. Ne e bëjmë këtë kërkesë, për këtë tender [shëno numrin e Pjesës, nëse aplikohet] si partner në konsorcium të udhëhequr nga [shëno emrin e udhëheqësit]. Ne konfirmojmë që nuk jemi duke tenderuar për të njëjtën kontratë me ndonjë formular tjetër. Konfirmojmë, si partner në konsorcium, se të gjithë partnerët, bashkërisht dhe veç e veç, janë të detyruar me ligj për realizim të kontratës; se partneri kryesor është i autorizuar të obligojë dhe të marrë udhëzime për secilin anëtar dhe në emër të secilit anëtar që realizimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat, është përgjegjësia e partnerit kryesor, dhe se të gjithë partnerët në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium janë të obliguar të mbeten në ndërmarrjen e përbashkët/konsorcium gjatë tërë periudhës së realizimit të kontratës.

7. Ne do ta informojmë Autoritetin kontraktues menjëherë nëse ka ndonjë ndryshim në rrethanat e mësipërme në cilëndo fazë gjatë implementimit të kontratës. Gjithashtu ne e dimë dhe pranojmë që të gjitha informatat e pasakta ose jo të plota të cilat jepen me qëllim në këtë konkurrim, mund të kenë si rezultat përjashtimin tonë nga kjo dhe nga kontratat tjera të finançuara nga BKK

8. Theksojmë që Autoriteti kontraktues nuk është i obliguar të vazhdojë me këtë ftesë dhe që e